

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga Mimoza Tasi kryesuese, Sokol Çomo relator, Albana Shtylla, Natasha Mulaj, Rezarta Schuetz anëtarë, shpalli vendimin për çështjen (JR) nr. 14/2020, datë 01.06.2020, që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Anila Guri kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 184, datë 19.07.2019.

Në përfundim të gjyqimit, trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash, vendosi:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 184, datë 19.07.2019 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Anila Guri dhe konfirmimin e saj në detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 10.06.2022.

POSTUAR NGA: NJOFTIME ([HTTPS://KPA.AL/CATEGORY/NJOFTIME/](https://kpa.al/category/njoftime/)), NJOFTIME ([HTTPS://KPA.AL/CATEGORY/NJOFTIME-SQ/](https://kpa.al/category/njoftime-sq/))

